



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 569/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Miran Halili, anëtar për Kuvendin Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Miran Halili, anëtar për Kuvendin Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri, me shenjen ZL.Anr.8569/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apel ZL.Anr.569/2017 me datën 09.11.2017, nga Miran Halili, anëtar për Kuvendin Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën thekson se e kanë votuar dy votues në vendvotimin 2710B/02R, mirëpo asnjëra votë e tyre nuk ekziston. Në mbështetje të pretendimeve në apel ka cekur emrat e dëshmitarëve të cilët e kanë votuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është i pabazuar**

Paneli pretendimet ankimore të apellesit i vlerësoi si të pabazuara dhe si të tilla i refuzoi për arsyes se gjatë hetimit të bërë nga ekipi hetues i PZAP-it me datë 11.11.2017 në kutin e votimit: 2710B/02R në QNR, konstatoi se në vendvotimin 2710B/02R në QNR nuk ka pasur ndryshim të votave nga numri i votave të shpallura me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 2232-2017 të datës 08.11.2017.

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase pretendimet e parashtruesit të apelit sipas hetimit të bërë nga PZAP, nuk qendrojnë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.Anr.569/2017 më datën 11.11.2017.

**Kryesues i Panelit**  
**Rafet Haxhaj**



***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*